



2325

155/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
SEKRETARIA TEKNIKE

Nr. 1148/5 Prot.

Tiranë, më 03 . 11 .2023

Lënda: Kthim përgjigje

QENDRA "RESPUBLICA"

Blv. "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë

Në vijim të kërkesës suaj, me nr. 155/23 Prot, datë 23.10.2023, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me nr. 1148/2 Prot, datë 24.10.2023, në lidhje me kërkesën tuaj për pajisje me kopje të akt-marrveshjes 3 palëshe, Ju bëjmë me dije se:

Bazuar ne Vendimin nr. 466, datë 16.09.2022, të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, pika 2 citon se: *"Zhvilluesi duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe, me një subjekt të licensuar në arkeologji që do të ndjekë kryerjen e punimeve dhe IKTK, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt..."*.

Sa më sipër, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore nuk e disponon këtë dokument pasi nuk rezulton të jetë lidhur akt-marrëveshje sipas vendimit të sipërcituar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klesta QIRICI

